

VENDIM
Nr. 314, datë 24.5.2023

**PËR MIRATIMIN E LLOJEVE DHE PROCEDURAVE TË LIDHJES SË
MARRËVESHJEVE TË POSAÇME (MEA)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 37/1, të ligjit nr.105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim ka si qëllim përcaktimin e llojeve dhe procedurave të lidhjes së marrëveshjeve të posaçme (MEA).

2. Llojet e MEA janë, si më poshtë vijon:

- a) Marrëveshje të posaçme me karakter financiar;
- b) Marrëveshje të posaçme të bazuara në performance;
- c) Marrëveshje të posaçme hibride.

3. Marrëveshjet e posaçme (MEA) me karakter financiar janë ato marrëveshje të cilat lidhen kur plotësohen një nga kushtet e mëposhtme:

a) Çmimi i propozuar është më i ulët se çmimi CIF, i miratuar nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë për një sasi të caktuar të barit për një periudhë të caktuar kohore;

b) Çmimi i propozuar është më i ulët se çmimi CIF, i miratuar nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe duke siguruar sasi barnash falas të të njëjtit bar mbi një sasi të kërkuar të barit për një periudhë të caktuar kohore.

4. Marrëveshjet e posaçme (MEA) të bazuara në performancë janë ato marrëveshje të cilat lidhen për barna originatorë me çmimin CIF më të ulët se çmimi i miratuar nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, që përfshihen në skemat e trajtimit terapeutik për grup të caktuar pacientësh ku risku i efektshmërisë së barit apo efikasiteti i trajtimit ndahet ndërmjet palëve.

5. Marrëveshjet e posaçme (MEA) hibride janë ato marrëveshje të cilat lidhen kur plotësohen një ose disa nga kushtet e përcaktuara në pikat 3 dhe 4, të këtij vendimi.

6. Bazuar në impaktin financiar buxhetor, barrën e sëmundshmërisë, protokollet e mjekimit si dhe opsionet e trajtimit të disponueshme në sistemin shëndetësor në vend, mund të përcjellin propozime pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë për lidhjen e një marrëveshjeje të posaçme (MEA):

- a) institucionet spitalore universitare;
- b) Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH);
- c) mbajtësi i autorizimit të tregtimit të barit në Shqipëri.

7. Institucionet spitalore universitare dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor përcjellin pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë propozimet për MEA, pas kryerjes së një vlerësimi paraprak të tyre, bazuar njëkohësisht në:

- a) impaktin financiar dhe disponueshmërinë buxhetore;
- b) protokollet e mjekimit;
- c) efikasitetin e trajtimit të barit, bazuar në evidenca shkencore;
- ç) vlerësimin mbi barrën e sëmundshmërisë, opsionet e trajtimit të disponueshme në sistemin shëndetësor për diagnozën që mbulon terapia në vend dhe shkallën e rëndësisë së trajtimit me terapinë e propozuar, bazuar në vlerësimin e kosto-efikasitetit.

8. Propozimet vlerësohen nga Komisioni *Ad-hoc* i Vlerësimit të Marrëveshjeve të Posaçme (MEA), i ngritur nga ministri përgjegjës për shëndetësinë. Procesi i vlerësimit kryhet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e regjistrimit të propozimit pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

9. Marrëveshja e posaçme pas vlerësimit nga Komisioni Ad-hoc i Vlerësimit të Marrëveshjeve të Posaçme dhe nënshkrimit nga palët i përcillet Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor ose institucioneve spitalore universitare për zbatim.

10. Kreu VIII, “Kontrata të posaçme (MEA)”, i vendimit nr.622, datë 22.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit”, shfuqizohet.

11. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe strukturat shëndetësore spitalore publike universitare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama